



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 825 prot.

Ballsh më, 22 . 02 . 2023

**VENDIM**

Nr. 09 Datë 21/02/2023

**“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTEVE TË MIRATUARA PËR VITIN 2023  
SIPAS VKB NR. 69, DATË 19.12.2022 ”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 20.12.2022 “Për miratimin e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2023”, VKB nr. 69, datë 19.12.2022 “Për miratimin e financimit të ndatë në dy vite të investimit”,

**VENDOSI**

1. Miratimin në parim të projekteve të investimeve si më poshtë:
  - Rikonstruksioni i rrugës Panahor – Ngraçan (Segmenti Panahor – Subashaj) dhe rruga Ballsh - Drenovë e Re (Segmenti Depo e Ujit – Shkolla)
  - Rikonstruksioni i rrugës Rromës – Qafa e Drenovës (Segmenti Qendër Rromës – Lagjia Tabakaj), rruga Fratar – Drizar dhe rruga Ninësh – Memaj - Damës
2. Bashkia Mallakastër merr përsipër zbatimin e gjithë procedurës ligjore dhe zgjidhjen e problematikave që mund të evidentohen gjatë zbatimit të projekteve të sipërcituara.

**KRYETAR**

**Fitim Baraj**

